



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Nr:5	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
<b>Data e mbajtjes:</b>	23.12.2022 Ora: 10:00
<b>Vendi i takimit:</b>	Salla e Kuvendit Komunal
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
<b>Procesmbajtës:</b>	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
<b>Anëtarët e Këshillit:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;</li><li>2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;</li><li>3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;</li><li>4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,</li><li>5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,</li><li>6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar;</li><li>7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;</li><li>8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;</li><li>9. Ganimet Shaqiri, Komuniteti Romë;</li><li>10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;</li><li>11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;</li><li>12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;</li><li>13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;</li><li>14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;</li><li>15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;</li><li>16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;</li><li>17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</li><li>18. Blendinela Shatri, EVSB;</li><li>19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;</li><li>20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;</li><li>21. Blendor Isufaj, KVRL;</li><li>22. Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“;</li><li>23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;</li><li>24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe</li><li>25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.</li></ol>
	<b>Mungojnë:</b> Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike;

Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi Gjinore  
Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të  
Arsimit në Komunë  
Enver Boletini, KLSP-Gurakoc

**Pjesëmarrës tjerë:**

Zenel Shatri, Drejtor i Shendetësis  
Xhavit Blakaj, Drejtor i Inspeksionit  
Lirije Demiri, Komuna Istog  
Blerim Gerguri, përkthyes,  
Suad Sadiković, OSCE,  
Atdhe Fetahu, RTV Fontana,  
Jeta Balaj, Komuna Istog  
Ardn Arifaj, Komuna Istog

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit,
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK -së
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. Parandalimi i radikalizmit që shpije në terrorizëm
6. Shtitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduara, prodhim i pa kontrolluar
7. Gjendja në institucione shëndetsore, ordianca mjekësore, raportet staf-pacient dhe furnizimi me medikamente nga lista esenciale etj.
8. Miratimi i Planit të Punës për vitin 2023
9. Të ndryshme

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Përsëndet të gjithë të pranishmit, anëtarët e KKSB-së. Përsëndet perfaqësuesit e KFOR-it Italian. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Para se ta hudhi në votim rendin e ditës më lejoni të theksoj se Vetëm Servete Haxhijaj dhe Enver Boletini kanë lajmruar për mospjesmarrje në mbledhje me arsytim, ndersa të tjerët nuk kanë lajmruar. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave**- si Koordinator i KKSB-së në përgatitjen e mbledhjes kamë dërguar ftesat me kohë dhe nga Nga Rreshter Arsim Zabeli, Drejtorja Kundër Terrorizmit-DPP Prishtinë, sotë kamë pranuar njoftimin se për shkaqe të angazhimeve me keqardhje nuk mund të marrin pjesë në Mbledhje, andaj propozoj që pika e pestë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** – Pyeti se tema E drejta në punë, është shtyr dhe nuk është siell më si tem për diskutim. Më intereson arsyeja.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-** Kam derguar kerkes Inspektoratit të Punës permes emailit dhe me qe nuk kamë marr konfirmim për pranin e tyre asht e pa kuptim ta lexojm një raport pa pas mundsi të debatojm rreth tij.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** – Kerkoj nga Ju që Koordinatori në emer të KKSB-së ti drejtohet serish Inspektoratit të punës me kërkesen që për mbledhjen e radhes në vitin e ardhshëm të kerkon nga Inspektorati ta dergojn një perfaqgues për paraqitjen e Raportit.

**Rendi i ditës u miratua me propozimin e Koordinatorit të KKSB-së.**

## **2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** –Pyeti antarët e KKSB-së a ka dikush verejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Me qe nuk pati vrejte, Nënkyetari pyeti kush është për miratimin e procesverbalit. Gjithë antarët e pranishëm të KKSB-së votuan për miratimin e procesverbalit.

## **3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** – vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policis.

**Toger Qazim Jahaj zv.Komandant i St. Policis Istog** - Gjëndja në zonën e përgjegjesis së stacionit Istog është e qetë, stabile. Në Vazhdimsi i paraqesim statistikat e rasteve, Këtë vit kemi shtim të rasteve në krahasim me vitin e kaluar. Aksidente në trafik perafersisht kemi raste të njëjta, tiketa në trafik kemi rritje në krahasim me vitin e kaluar ndersa dhunë në Familje kemi dukshëm ramje në krahasim me vitin e kaluar.

Këtë vitë në veçanti jemi perqendruar në Planin Operativ (PO), siguria në Shkolla që ka ndikuar në ngritjen e bashkëpunimit Polici-DKA, Drejtori të Shkollave dhe Këshillat e Prindërve. PO Trotuaret e Lira. Në kuader të këtij Plani në veçanti kujdes të shtuar serish ju kemi kushtuar trotuareve në afersi të Shkollave. PO, siguria në trafik, aksidentet, kontrolla e trafikut nderurban në veçanti autobusve, pastaj PO për kontrollin e lokaleve pa leje pune apo mos rrespektimin e orarit të punës. PO për parandalimin e Viedhjeve me qe kemi pas rritje të këtyre rasteve.

Po i perdorimit të prones publike dhe janë hapur disa raste për keqperdorime.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** – Edhe në mbledhjen e kaluar kam kerkuar që raportmet të jen ma seleksionuese. Rastet e rënda , rastet e narkotikve në veçanti në Shkolla, cili asht niveli i zbulimit të rasteve apo të viedhjeve sa është zbulueshmeria.

**Toger Qazim Jahaj zv.Komandant i St. Policis Istog** - Po kerkesa juaj është e drejt, ne kemi njesi të veçanta që merren me çeshtjen e shperndarjes dhe perdorimit të drogave. Kemi pas raste kur kemi zbulu dhe hap procedura, flitet që ka qytetar që merren me këtë aktivitet, andaj janë njesit e profesionalizuara. Sa ju perket viedhjeve e ceka se kemi pas PO dhe kemi zbulime të rasteve por jo ai i duhuri.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - E falenderoj togerin dhe pyeti a ka dikush nga antaret pyetje apo diskutim. Me që nuk ka kalojm në piken e radhes të rendit të ditës.

#### **4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqgues të komuniteteve etj.)**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Me që perfaqsesit e KFOR-it dhe FSK-së nuk janë të pranishëm pyet perfaqsesit e institucioneve tjera a kanë ndonjë çeshtje për ta diskutuar.

**N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;** Ju informoj që FSK-ja është duke i mbajur disa trajnime në Shkolla rreth perdorimit të mjeteve piroteknike dhe procedurave me mjetet e pa shperthyera. Kto trajnime jemi duke i mbajt në nivel Kosov, poashtu edhe në Komunën e Istogut. Deri me tani kemi Mbajt trajnimin në Gjimnaz, Planifikojm edhe në Vrell dhe Rakosh.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Jemi në prag të festave ku perdorimi i mjeteve piroteknike është prezente andaj edhe ne si Komunë, gjegjesisht Drejtoria e Emergjencave Mbrotjtje dhe Shprtim ka paraqit komunikaten për kohën, moshën dhe mënyrën e perdorimit bazuar në Legjislacionin në fuqi. Gjithashtu e pergëzojm FSK-në për iniciativen e lidhur me temen që ka të bëj me festat e fundvitit.

**Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim-** pershendetje anëtar të KKSB-së dhe ju të pranishëm. Po e permyllim një vitë kalendarik dhe gjendja në Arsim, bazuar në informatat nga Drejtorit e Shkollave ka qën i suksesshëm dhe siguria në Shkolla dita dites po rritet fal edhe bashkëpunimit të mirë me Policin e Kosovës. Nga ra[porti i fundit siguria në shkolla ka një avancim me që pos bashkëpunimit me Polici tani edhe kujdestarët e klasve pothuajse në baza javore po kryejn kontroll të nxënësve në klasen e vetë për posedim të armve të ftohta apo elemente tjera të ndaluara me Ligjet në fuqi. E kuptoj angazhimin edhe të Policis por megjithata kerkoj angazhim maksimal për një angazhim në afersi të Shkollave për të parandaluar perdorimin e mjeteve piroteknike me qellim mos të kemi nxënës të lenduar. Edhe një herë falenderoj Policin e Kosovës dhe gjithë bashkëpunëtorët që kan dhën kontribut që sigurin në shkolla ta kemi në nivel më të lartë.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Falenderoj Drejtorin e DKA-së dhe pyet a ka tjerë antar të interesuar për diskutim. Me që nuk ka tjer diskutues kalojm në piken e radhes të rendit të ditës.

**5. Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduara, prodhim i pa kontrolluar**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, në përgatitjen e mbledhjes ftesa është dërguar Agjencionit të Ushqimit dhe veterinarisë të Kosovës (AUVK) të cilet e kanë konfirmuar se do e delegojn një përfaqësues për raportim dhe debat por nuk jemi në dijeni për arsyet e mospjesmarrjes së tyre, andaj fjalën ja kalon z. Xhavit Blakaj nga Drejtorati i Inspektoratit Komuna Istog.

**Xhavit Blakaj, Drejtorati i Inspeksionit** - Realisht tema e debatit i perket më shumë fushveprimtaris së AUVK-së. Besoj se jeni në dijeni që si Drejtori deri në janar e kemi pas inspektorin sanitar në kuader të Drejtoratit por që me riorganizimin ka kaluar në kompetenca të nivelit qendror andaj është transferuar me detyr në Pejë. Megjithatë këtë vushveprimtari e rregullojn Ligjet, Udhëzimet Administrative nga AUVK dhe Rregulloret komunale. Ka theksuar tri ligjet që e rregullojn qeshtjen, nese ka ndonjë pyetje konkrete bazuar në njohurit e mija mund të jap përgjigje

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - kërkoj nga Koordinatori që për mbledhjen e ardhëshme ta kontaktoj serish AUVK-në dhe ta dërgoj ftesën që të debatojm për këtë temë.

**6. Gjendja në institucione shëndetsore, ordianca mjekësore, raportet staf-pacient dhe furnizimi me medikamente nga lista esenciale etj.**

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - fjalën ja kaloj Drejtorit të Shëndetsis-së, për një informat

**Zenel Shatri, Drejtor i Shëndetsisë** - Pershendes të pranishmit, gjëndja në shëndetsi në komunën tonë është relativisht e mirë. Dëshira është të jet në superlativ por ka shumë faktor që ndikojn. Besoj që jeni në dijen se sistemi i organizimit është QKMF-Istog mjeksia familjare dhe emergjenca e cila funksionon 24 orë, kater QMF Rakosh, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë me orar të punës 12 orësh, ndersa të shtunen deri në ora 12.00. I kemi 8 ambullanta në fshatra, i kemi aktivizu ne Cerrkolez dhe Veriq, mjeku kujdestaron dy her në javë. Ambullantat janë mirë të furnizuara me medikamente. QKMF është e furnizuar me oksigjen koncentrator, dhe me mjete elementare për kryerjen e shërbimeve emergjente të nivelit tonë. Kryhen shërbime këshillimore për gjinekologji. Raporti i stafit mjeksor-popullat është i mirë. Nuk kemi staf të mjaftueshëm për të gjitha ambulancat. Kryejm shërbimet e pacientve në dializ duke i drguar me automjet, poashtu edhe rastet me sëmundje karcinome au hjekim shpenzimet e udhtimit (naftën) apo kur janë në gjendje të rand i transportojm ne me automjete të QKMF-së. Poashtu per smundje kronike i ndihmojm me mjete financiare me që terapia është e koshtueshme. Kemi konsulent një Psikiater dhe një Gjinekolog. Furnizimi me barëra nga lista esenciale është relativish e mirë duke falenderuar edhe vullnetin e mirë të Kryetarit kemi bler rreth 60.000€ barëra me që ka munguar furnizimi nga Ministria. Probleme nuk kemi të theksuara. Jamë i hapur për pyetje.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** - Raporti staf pacient është pik e rëndësishme, etika e shëndetsis sa është në funksion ky raport. A ka ambicje Drejtorati të ketë Specialist të fushave të ndryshme.

**Zenel Shatri, Drejtor I Shëndetsisë-** Me organizimin në nivelin tonë përpos mjeksis familjare nuk parashihen specialist të tjer. Si konsultant mund të merren Gjinekolog psikolog dhe lami tjera të nevojshme. Me Ligje dhe Rregullore janë të parapara kto modele.

Sa i perket barnave nga lista esenciale nuk janë të plotsuara 100% por ato që janë të domosdoshme i kemi plotsuar ne si komun si psh. Insolina, Oksigjeni etj.

Raporti staf pacient relativisht i knaqshem, janë dy palët të perfshira. Nga njëher pacientet nuk janë në dijeni cilat shërbime mund ti afrojm dhe pritjet janë më te mëdha.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Falenderoj Drejtorin e Shëndetsis dhe kalojm në piken e radhe s të rendit të ditës.

Lajm i mirë është nga Komandanti se në përgjithsi përjashtimisht incidenteve të vogla, situata rreth siguris në Shkolla është e mirë dhe Stabile. Normalisht nuk duhet përjashtu as atë që Skenderi e paraqiti por rasti qenka menaxhu nga Policia dhe procedu më tutje. Detyra jon si Këshill është parandalimi i dukurive negative. Me që nuk ka tjera diskutime kalojm në piken e radhës të rendit të ditës.

## 7. Miratimi i Planit të Punës për vitin 2023

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Për ta paraqitur Planin e pones, fjalën ja kaloj koordinatorit të KKS-së

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-** Të gjithë antarve të KKS-së ua kam dergu Planin e Punës për vitin 2022 si model i hartimit të Planit për vitin 2023. Deri me sotë kam marr propozime nga Zyrtarja për barazi gjinore, EVSB, HANDIKOs dhe perfaqsesi i komunitetit Boshnjak ka kerku falje që me vones e ka par emailin. Më duhet të konstatoj se serish po shifet se nuk jemi në nivelin e përgjegjësis dhe po mungon angazhimi.

Unë kam propozu një tem të re Abuzimi me fëmij minorë dhe adoleshent, nga blandineta është pothuajse i njëjti propozim vetem se është theksuar në Shkolla dhe Bulizmi në Shkolla. Propozoj që tema e parë E drejta në punë të analizohet me që po mungon bashkëpunimi me institucione qendrore e që ne si këshill nuk kemi kapacitete për ti mbuluar dhe debatuar, poashtu edhe tema e Radikalizmit, Policia e Kosovës gjegjësisht Drejtoria qendrore e ka një njësi për këtë tem dhe në mbledhjen e kaluar nuk kanë qenë prezent, andaj këto dy tema duhet analizu a të shtim në planin e punës.

Zyrtarje për barazi gjinore ka propozuar temen Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit në institucionet publike. Tema tjetër nga Blandineta është Sanimi i gjendjes nga fatkeqsit natyrore.

Me nënkryetarin i kemi analizu dhe jemi pajtu per shumë pika apo tema të Planit aktual të hyjn si plan i vitit 2023.

Tema për trotuare dhe pjerrin është propozim i perfaqseses së HANDIKOS-it që të jetë tem për planin e vitit 2023.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Temat e propozuara edhe nga disa antar të paraqitura nga Koordinatori të na sherbejn për Planin e vitit 2023. Sikur se e potencoj koordinatori kerkoj angazhim të të gjithë antarve. Nese nuk keni ndonjë tem konkrete nuk po e shoh të arsyeshme të shkojmi për çdo tem veç e veç por si tersi me plotsimet e propozuara.

**Blendor Isufaj, KVRL** - Kerkoj falje që nuk kamë derguar propozimet me shkrimme koh por propozoj që si temë të jetë dhuna seksuale në veçanti ndaj personave të mitur.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Falenderoj Blendorindhe konstatoj që tema e propozuar nga ana juaj është perafersisht e njëjta me propozimin e Blendinetes dhe sugjeroj të inkorporohet dhe të formulohet si një temë.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** - Problematikat janë të përfshira dhe të ndara mirë në kapituj, por propozoj që tema nga Arsimi dhe Shendetsia mos të trajtohen vetem në një mbledhje por të jenë tema që së paku dy her në vitë në prill dhe në tetor.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave**- Pajtohem me profin që tema nga shendetsia të trajtohet dy her në vitë por sa i perket Arsimit me që Drejtori i DKA-së është antar i rregullt i KKSB-së në piken e Katert të rendit të dites në gjitha mbledhjet e kemi mundsin me debat u rreth arsimit dhe problemeve aktuale në Arsim.

**Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës** - Pasi që nuk ka të lajmruar për fjalë, propozoj që temat e paraqitura si propozime qoft me shkrimë qoftë tani në mbledhje të inkorporohen në Planin e Punës dhe ta miratojm si KKSB. Miratohet Plani i Punës nga të gjithë antarët e pranishëm.

Me që është mbledhja e fundit për këtë vit më lejoni ta bëj një permbledhje vjetore.

Ta marrim seriozisht, pjesmarrjen por edhe angazhimi jonë me qellim që ta permbushim misionin tonë si këshill konsulltativ. Sikurse e potencova edhe ma heret kerkoj nga koordinatori që per mbledhjen e radhes ti kontaktoj institucionet pergjegjëse dhe të jenë tema të diskutimit-analizes dhe rekomandimeve konkrete. Si tem të veçant kerkoj nga Policia që patrullat e Policis të jenë ma prezente në SHFMU Bajram Curri në veçanti gjatë ndrrimit të ciklit për të parandalu tollovin me automjete në oborrin e shkolles.

Ju falenderoj për bashkëpunimin në këtë vitë, ju uroj festat dhe mbarsi në vitin e ardhshëm. Mirupafshim në takimet e radhes.

**Mbledhja perfundoj:**

11.20